



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 36, datë 27.01.2021

**MBI VERIFIKIMIN E FIGURËS, PASURISË DHE PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE  
TË PARASHIKUARA NGA LIGJI PËR SHËRBIMIN CIVIL PËR KANCELARIN NË  
DETYRË NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË  
VLORË,  
Z. PËRPARIM HOXHA**

Bazuar në germën “e”, të pikës 1, të nenit 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 1, të nenit 189, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në germën “d”, të pikës 1, të nenit 1, dhe pikën 1 dhe 2, të nenit 76, dhe në nenin 111, të Ligjit Nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në germën “e” të nenit 21, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe pasi u njoh me Raportin me rezultatet “Mbi verifikimin e figurës, pasurisë dhe plotësimin të kushteve të parashikuara nga ligji për shërbimin civil, për z. Përparim Hoxha, kancelar në detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Të konsiderojë të përfunduar procedurën e verifikimit të figurës, pasurisë dhe plotësimin të kushteve të parashikuara nga ligji për shërbimin civil për z. Përparim Hoxha.
2. Të miratojë raportin me rezultatet e verifikimit të figurës, pasurisë dhe plotësimin të kushteve të parashikuara nga ligji për shërbimin civil për z. Përparim Hoxha, kancelar në detyrë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
3. Të konfirmojë marrëdhënien civile ekzistuese për z. Përparim Hoxha.
4. Të njoftohet për këtë vendim z. Përparim Hoxha, Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**



**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**

**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**

**ANËTAR  
VATË STAKAJ**

**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**